

krisja e parë e kujtimit të dytë

jemi vetëm dashuria ime

jemi vetëm

haj merr kurajo merre zemrën

(prej rrezesh)

në dhëmbë e rri majë gishtave

hiqu sikur po fluturon

na u shpif nga kaq përkufizime të jetës

me kaq shpjegime “jeta është e bukur / e shkurtër, meriton të jetohet”

kot fare!

jemi vetëm dashuria ime

jemi vetëm pijmë petrosin

mirpo marrin flakë muret e shtëpive tona

në stacionin e trenave të konstancës me një tufë

almanakësh të para '89-ës

grisim me kujdes faqet e para

i vemë në korniza

jemi vetëm dashuria ime

ne dhe çaushesku i pushkatuar tani

varur në vend nderi në kornizë

dhe nata që struket mes nesh

si një kërmill pse po rend

tani pas trenit pse ulërin pse trembesh

jemi vetëm mon amour

këtej s'kalojnë njerëz

këtej kalojnë trena

më zuri nepsi për një pjeshkë por s'ndjej

veç rrugën rrotat e trenit mbi shinat e bymyera

një aromë nxehtësie...

krisja e dytë e kujtimit të dytë

të thuhet në një çast të caktuar

“do të vuash si një qen”

ty të vjen të qeshësh

ngujimi dhe vetmia s'janë shpëtimi im

ngujimi dhe vetmia janë vrasja ime

si dreqin të mos jemi të trishtëm

kur vetë zoti është një banor i mjerë

i apartamentit në katin e dytë

e përmbyt看 gjithnjë

kur çahet tubi dhe nëna

s'ka kohë të thërrasë ustanë

ahere oh këmbët e tij të shenjta

ngrijnë në qilimin
e mufatur nga uji i ftohtë
si të mos dridhesh nga thëllimi në dimër
nëse zoti është një banor
i shturur që sheh me dylbi pallatin përballë
vajzën që në vetëm njëzet-njëzet e dy vjeç i ka
gjinjtë aq të varur
e që mbush pa ia qëlluar kurrë
sytjenat me sfungjer
pó ata sytjena të zinj dalëboje
si të mos jemi të trishtëm kur zoti
i bje me dorë duke qarë...

këtu s' shkruhen poezi as letra dashurie
shumë rrallë na shkon mendja tek burrat
e kur ndodh i dërgojmë
atje ku është ngrohtë e mirë
një femër kalon pranë meje
lëkura e rruar e sqetullës së saj
si shpina e dërrit.
mbyll kopsën e mbrame të këmishës
i mblodha gjërat shpejt
dhe i nguca në dy qese plastmasi
tani pres të ik.
gjurmët e mia janë ca njolla të stisura
gjaku e qelbi lënë mbi çarçafin e stisur
dhe ky brumbull i kaftë
që e kaloj nga njëra shuplakë në tjetrën
s'mund të jetë më shumë së një brumbull
shkulur ëndrrë... atëhere pse më duket
sikur më endet nën lëkurë?

krisja e tretë e kujtimit

qysh tani do të nisin
të pluskojë mamaja dhe shtëpitë përreth
fabrika e çimentos në skaj të qytetit
po trokita në mur
muri tingëllon si bosh
mishi im i mavijosur nga e ftohta
gajasem e ngrirë më këmbë
duke u çmeritur mes çarjes së murit
të shoh në cep të udhës anësore
mbuluar kokekëmbë
me një tis të hollë çimentoje
tek tërheq pas vetes një tufë

ushtarësh teneqeje
nderon me dorën tek kapela
pastaj ngrihesh në ajër
si një flluskë sapuni

(Fisuri, 2003)

rumania. fin de siècle

*njoh më në fund maskarallëkun e njerëzve të butë
i njoh këta njerëz me duar të lagëta
rrumbullake, gati të ledhatojnë këdo*

ka ditë kur
secili prej nesh
mund të jetë i paqëndrueshëm dhe meskin.
vendimin për të mos vdekur
për të bërë qëndresë
e morëm edhe ne
bijtë e mjerimit
fajtorë që u lindëm
mes dy shekujsh
mes një rradhë mishi
e një rradhe vezësh
për krishtlindje pamë
njerëz të shqyer direkt
u rritëm në bark të qenit
që atë natë
u nginj me tru të freskët
sot marrim vesh se njerëzit
paskan vajtur me dëshirë
dhe i dorëzuan miqtë ne duart e sigurimit
tradhtia don të bëhet modeli ynë
na jep mësim mirësjelljeje:
mos bëni seks mos u drogoni
mos shkruani fjalë të ndyra
jini metafizikë
mos vrisni veten
mos vrisni prindërit

presim të qetë
që jeta jonë
të marrë udhën e letrës

*

e tashmja jotë është si danubi
e ardhmja – si ríni
dy krahë të ndehur

dy krahë binjakë
njëri i nxirë nga gjilpërat
tjetri me lëkurën leskruar

përcëllimi i fillimshekullit
kur as bari s'është më ç'ka qenë
nuk rritet
në fund të pellgjeve me gjak
apo në vendin ku u thërrmuan
dhëmbë e brinjë e kafka
ja rumania ime:
e ardhmja e saj ka filluar
njëherësh me
vdekjet e saj të mëdha.
kush vdes sot?
poeti.
cili vritet sot?
fëmija.

histori e afërt

kështu janë punët:
nëna s'do të ikë kurrë
nga rumania
babai s'do të ikë kurrë
nga rumania
në vdeksh s'do të ikësh kurrë
nga rumania

shampot që mbledh
nëpër banjat e hoteleve të tu, evropë
kanë të njëjtën aromë
si kolonja *margaritar*
blerë në duhantore
*s'kupton që gjërat s'janë edhe aq të ndryshme atje
ku s'do të mbërrish më?*

*

historia është një copë muri
në një qytet në lug të evropës
historia është një cep fotografie

në çdo *aurolac*¹ zhelan
ka diçka prej meje
në burrat e dehur plot të vjella
në trimat e popullit tonë
që kutërbojnë të gjithë era shurrë e makth

¹ Lypsa të vegjël, që drogohen me pluhur varaku.

jam unë dhe emri im
është rumania.

pasuria ime: disa qindra libra
një legen i kuq plastiku
një hekur i përdorur rrobash
një radio
një komplet çaji
ngjyrë dheu
një shpirt krenar dhe i pamëshirshëm
një lëkurë e munxosur
një zot i pikëlluar
një dëshirë si faj vdekjeprurës

ti shëtit udhëve të një qyteti në
lug të evropës
paburrninë dhe mungesën time të shpresës

letra e dytë për nikosin

zgjate dorën prek e ndjen murin?
këtu s'na sheh askush
këtu jemi në siguri
me ne është një mur i madh i trashë
mund të putheshim të përkëdheleshim të prisnim
sekset por kjo s'ka tashmë
kurrfarë rëndësie
thërrmojmë edhe ne me këmbë
qerpiç prej zorrësh bualli marrim pjesë
në ngritjen e historisë sonë kombëtare / zonale
ftohtësinë e ditës e dëbojmë me lagështinë e gjakut

*ishim në dasmë
qemë të lumtur
njerëzia shtinë me pushkë
asgjë e keqe atëhere ranë
bombat atëhere mbetëm
pa krahë s'do ta kap
asnjëherë pushkën me dorë
fëmijët dëgjojnë natën
këngë lufte
një histori e përshkuar pash më pash nga kujat*

të kërkova mes rrënojave
të qytetit veshur si ndonjë afgane
takova fëmijë të verbër
që mbanin me vete
kafkën e mbretit të sapovrarë

duke e valëvitur majë hellit
pse kërkon të dish më shumë
për këtë femër
iluzionet s'kanë trup e as shpirt
vendi im? këtu kurrë s'ka rrjedhur qumësht e mjaltë
as ka për të rrjedhur ndonjëherë

një dimër për tim vëlla

prolog

mon amour, mon frère
do të ndërtoj një dimër për ty
ngjitem me gji pas dëborës
dhe gjiri im është i thatë
dhe feminiteti im zhduket si hiri!
mes zemrës sime është rritur një yll
mund të më përqafosh sikur të isha djalë
ti je vëllai im i dhimbjes i vdekjes
jo nga lindja jo prej nënë-e-babe
kapemi përdore e për dore
shkojmë para gropës sonë
jemi fëmijët e mëngjesit fëmijët e mbrëmjes
fëmijët e mesnatës
ku janë prindërit të na thonë
cilët jemi ne në fakt
e ç'kërkojmë në këtë qytet
ku ç' do gjë që prekim shndërrohet
në trupa pa shpresë

*

më thuhet se të gjitha këto
janë shenjat e panikut
në vend që të ulërish të godasësh me grushte e shkelma
hesht e dridhu
është si një rënie kalçiumi
si një rroposje kur gjithçka hapeeeet
dhe mbylleeet...
e ti s'je veç ajo mpirje gjuhe para të vjellës

epilog

sa herë më kap mëshira për veten
ti je aty lëkura jote është ngjitur me timen
brinjët tona takohen

cili është ky burrë krahëprerë nga vjen?
kur zgjohem në mesnatë

e shoh te kryet e shtratit me mbetjet e krahëve gjakosur
plagët e tij janë gjithnjë kaq të freskëta
thua se sapo kanë dalë nga thika

fytyra jote më turbullon paqen e secilës ditë
kur kam mëshirë për ty je këtu pranë meje

t'i prenë flokët ta rruajtën mjekrën
të lanë presa të thella në fytyrë
duart e tua janë gjithnjë e më të ftohta
hyra në sheshin e spitalit si në një kasaphanë
je qengji im kam ardhur për ty
je qengji im kam ardhur të ta ndeh
fytin mbi brisk
s'kam mëshirë për njeri kam mëshirë për vete

Qyteti

gjer edhe këta dhëmbë porcelani
që i sheh tek rrokullisen mbi shkallë
kanë më tepër jetë se unë
një masë për gjithçka:
ngadalësia me të cilën lëvizim
në këtë ajër detar
mes dhjetra kukullash vigane
me eshtra që iu shpojnë lëkurën e kalbur

tokë është rreth nesh
tokë sa kap syri
tokë e ftohtë dhe gëlltitëse
si një fetë keku njomur në çaj

këtu gjithë dynjaja do të na shesë nga një gjë
pudra çorape receta dobësimi shpëtimin
jemi po aq të vetmuar e pa kuptim
sa fotografitë me aktorë në korridoret
e shtëpisë sindikale të kulturës
gjithçka është pakashumë e kuqe
jeta jonë është pakashumë e kuqe
të ndihmon rumania të harrosh apo të shërohesh?
një ditë do të hipë në tramvaj
një burrë i armatosur
do të më vrasë
se nuk jam e bukur
se nuk i pëlqen ecja ime
se nuk i pëlqejnë veshjet e mia

kur kthehem në shtëpi

shembet afër derës mbajtësja e hekurt e gjyshes
(nëna do ta kish varrosur
bashkë me atë mbajtëse
po të mundej)
nga muret shkëputen qengja
me gjuhë të ashpra e gjatoshe
iu zgjaten anës buzëve
dynden mbi mua
marrëzia vjen ngadalë
marrëzia është një miush i bardhë
(e)dhe frika është një miush i bardhë

*

babai ngërdheshet
mbi duar i bjenë pika gjaku
ose jargësh
është i vetëm im atë
para një muri të lartë gjer në qiell
mur i bardhë

i afrohem
fort të grisur e ka golfin në fyt e në mëngë
shtëllunga pambuku i dalin nga sytë e nga goja
i rëndo me brisk në plagën e këmbës
tani plaga ngjan me barkun e çarë
të një miushi të bardhë
mbi qytet kam ndehur
një çarçaf plot vrime.

(europa. zece cîntece funerare, 2005)

Shqipëroi Ardian-Christian Kyçyku